

## **“Shpallja e Programit të Specializimit dhe Aftësimit Profesional”**

Autoriteti Portual Durrës dhe Qendra e Ekselencës për Çështjet Detare, shpallin thirrjen për “Programin e Specializimit dhe Aftësimit Profesional, me pagesë”, program i cili do të mbështetet financiarisht në kuadër të aktiviteteve që zhvillon Qendra e Ekselencës për Çështjet Detare.

**Ky program ofron 10 kontrata pune, për një periudhë 6 mujore deri në 1 vjeçare, duke u dhënë mundësinë profesionistëve të rinj që të përfshihen në një eksperiencë pune të mirëpaguar dhe në ndërveprim me profesionistë karriere në administratën portuale, me qëllim përfitimin e një përvoje kualifikuese që ndikon në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale e të shprehive të tyre në praktikë.**

Gjatë specializimit, personat e përzgjedhur do të vendosen në sektorë/njësi organizative të caktuara të APD dhe do të punojnë nën udhëzimet e mbikëqyrësve të sektorëve/njësive përkatëse.

**Profilat e kërkuara për plotësimin e 10 vendeve vakante janë:**

- **Inxhinieri Mekanike/Ndërtimi**
- **Finance dhe Biznes**
- **Navigacion - Menaxhim Detar/ Inxhinieri Navale**
- **Teknologji informacioni/Cyber-security**

**Aplikantët që do të paraqesin kërkesën për të qenë pjesë e këtij programi duhet të plotësojnë minimalisht këto dy kushte:**

- a) të kenë përfunduar arsimin e lartë (niveli bachelor) me rezultate të mira, brenda apo jashtë vendit (Masteri i përfunduar ose në proces konsiderohet një avantazh);**
- b) të jenë të moshës deri 30 vjeç.**

**Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet nga një Komision Përzgjedhje, me përparësi, si më poshtë vijon:**

- a) sipas rezultateve akademike,**
- b) sipas fushave të studimit me interes, referuar objektivave të APD dhe CEMA,**
- c) sipas CV dhe formimit të përgjithshëm të aplikuesit.**



Centre of Excellence  
for Maritime Affairs



Autoriteti Portual Durrës  
DURRËS PORT AUTHORITY

### **Dokumentacioni që duhet të paraqesin aplikantët:**

- **Formular Aplikimi (gjendet online në faqen ëeb të APD)**
- **CV dhe fotokopje të kartës së identitetit**
- **Diplome dhe listë notash e noterizuar**

Në fund të specializimit, pjesëmarrësit do të pajisen me një certifikatë mbi ndjekjen e programit nga Qendra e Ekselencës për Çeshtjet Detare. Sipas praktikës së konsoliduar tashmë pranë APD, pjesëmarrësit e dalluar do të konsiderohen për mundësi punësimi afat-gjatë pranë APD/CEMA.

Aplikimi nga praktikantët do të bëhet në rugë elektronike duke ndjekur udhezimet në faqen ëeb të Autoritetit Portual Durrës, dritarja Praktikat Mësimore/Profesionale.

**Afati përfundimtar i pranimit të aplikimeve është data 03.06.2024**